

# AKT THEMELIMI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “ENA & More” SH.P.K.

## Neni 1 **Formimi**

Sot me datë 05.02.2025 mbështetur në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë në përputhje me Ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë Tregtare”, Kodin Civil dhe Ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Biznesit” themelohet shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “**ENA & More**” SH.P.K.

Kjo shoqëri krijohet nga:

1. **Yıldırım Ardahanlı**, i datëlindjes 16.02.1968, lindur në Turqi dhe banues në Tirane,

## Neni 2 **Selia**


Selia e Shoqërisë me Përgjegjësi të Kufizuar “**ENA & More**” SH.P.K. është në adresën: **Rruga Astrit Losha, Pallati Marituda, Zona Kadastrale 3866, Pasuria Nr. 300/142, Katë i pare, Dyqani Nr. 15, Kashar, Tiranë**.

## Neni 3 **Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar “**ENA & More**” SH.P.K. është e pacaktuar.

## Neni 4 **Objekti Veprimtarisë**

1. Të importojë, eksportojë të gjithë llojet e konfeksioneve, tekstileve, veshje, veshimbathje, copa etj
2. Tregtimi me shumice dhe pakice i të gjithë llojet e konfeksioneve, tekstileve, veshje, veshimbathje, copa etj
3. Të importoje dhe eksportoje fruta te thata
4. Të tregtojë me shumicë dhe pakicë fruta te thata
5. Te importoje dhe eksportoje
6. Tregtimi i të gjitha llojeve të tekstilit shtëpiak dhe zbukurimeve



7. Importi eksporti dhe tregtimi me shumicë dhe pakicë i të gjitha produkteve ushqimore.
8. Të kryejë çdo lloj pune që lidhet me ndërtimin
9. Të tregtojë bojëra makinash dhe ndërtimi
10. Të tregtojë çdo lloj materiali ndërtimi dhe izolimi
11. Konsulencë teknike dhe profesionale në dobi të bizneseve, OFJ, Bankave dhe individëve, vendas ose te huaj.
12. Konsulencë ligjore dhe të financimit të biznesit, asistencë në lidhje me proçedurat e kërkua sipas kuadrit ligjor në fuqi.
13. Hapja dhc menaxhimi i agjensive të pasurive të paluajtshme, të makinave, makinerive etj. Të kryejë ndërmjetësimë në shitblerje dhe dhënie me qira. Shërbime të vlerësimit të pasurive të paluajtshme.
14. Të asistojë sipërmarrjes në bujqësi dhe çdo kategori biznesi me konsulencë për implementimin dhe certifikimin e produkteve dhe biznesit me sistemet e sigurisë ushqimore dhe standarte të tjera si HACCP, GlobalGap, ISO, Organic etj.
15. Planifikimin strategjik dhe hartimin e buxheteve të projekteve, mbikqyrjen e progresit të projekteve, hartimin e programeve të vlerësimit.
16. Studimi dhe realizimi i programeve dhe projekteve për zhvillimin rural, bujqësor e mjedisor, në të mirë dhe interes të publikut, me fonde të siguruara nga donatorë të huaj ose të vendit, publikë ose privatë.
17. Këshillime, monitorime dhe vlerësime të shërbimeve rurale, bujqësore në funksion të mbrojtjes dhe konservimit të mjedisit rural.
18. Përdorimi i teknologjive dhe sistemeve të informacionit në hartimin e politikave dhe vendim-marrje. Mbledhja dhe integrimi i të dhënave dhe treguesve socio-ekonomikë me ato gjeografikë e hapësinorë në shërbim të përmirësimit të politikave të rritjes së cilësisë së shërbimeve për zonat në zhvillim në përputhje me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm
19. Studime kërkimore ekonomike dhe përgjithësimi i arritjeve në lidhje me zhvillimin e integruar ekonomik, zhvillimin e qëndrueshëm bujqësor e mjedisor.
20. Të hapë dhe menaxhojë agjensi turistike dhe udhëtimi
21. Të operojë në fushën e turizmit
22. Të importojë, eksportojë dhe të shesë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e fruta dhe perimeve.
23. Të importojë, eksportojë dhe të shesë me shumicë dhe pakicë të gjitha llojet e produkteve me sheqer, produkte të konservuar, pije alkoolike dhe joalkoolike.
24. Të transportojë mallrat e tregtuara nga ana e saj me mjetet e veta ose të kontraktuara për përbushjen e aktivitetit të saj.
25. Të shërbejë si distributor i shoqërive dhe markave të ndryshme vendi dhe të huaja. Të përfaqësojë shoqëri të huaja.
26. Të kryejë shitblerjen me shumicë dhe pakicë të të gjitha materialeve dhe shërbimeve të lejuara nga legjislacioni shqiptar.

## Neni 5

### Kapitali i Shoqërisë

Kapitali themeltar i shoqerisë “**ENA & More**” SH.P.K. është 100.000 (Njëqind mijë) Lekë, i ndarë në 1 kuota si vijon:

1. **Yıldırım Ardahanlı :** Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqind mijë) Lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

## Neni 6

### Organet e Shoqërise dhe Asambleja

Organet drejtuese të shoqërises “**ENA & More**” SH.P.K. janë:

- Asambleja e Ortakëve, organi më i lartë vendim – marrës.
- Administrator i shoqërises, është **Z.Yildirim Ardahanli**. Shoqëria do të administrohet nga **Z.Yildirim Ardahanli**, si administrator i saj, i cili përfaqëson shoqërinë në marrëdhieniet me të tretë për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

## Neni 7

Të drejtat e detyrat e asamblesë, organizimi i shoqërises, marrëdhieniet me persona fizikë e juridikë vendas apo të huaj, shprehen në statut, i cili bashkë me aktin e themelimit janë dokumentat bazë të veprimtarisë dhe shërbejnë për zhvillimin e aktiviteteve të saj.

## Neni 8

Veprimtarinë e saj, shoqëria do t'a zhvillojë në përputhje me legjislacionin Shqiptar.

## Neni 9

Të gjitha mosmarrëveshjet me persona fizikë ose juridikë si dhe me organet shtetërore zgjidhen me mirëkuptim, me anë të dispozitave të ketij akti, statutit dhe legjislacionit shqiptar dhe kur këto mjete nuk japid rezultat atëherë zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Ky Akt Themelimi hyn në fuqi ditën e regjistrimit të shoqërises me përgjegjësi të kufizuar “**ENA & More**” SH.P.K. në Qendrën Kombëtare të Biznesit, Tiranë. Në këtë ditë shoqëria “**ENA & More**” SH.P.K. njihet si person juridik.

## Neni 10

1. Ky akt formulohet në gjuhën shqipe dhe nënshkruhet në 1(një) kopje.
2. Ortakët e shoqërises i japid të drejtën **Z.Yildirim Ardahanli**, të paraqitet pranë QKB-së dhe çdo institucioni tjeter për regjistrimin e shoqërises “**ENA & More**” SH.P.K.

**ORTAKU I SHOQERISE**

**Yildirim ARDAHANLI**